

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN

“PËR KONTROLLIN E KUFIRIT SHETETËROR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, ka si qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit kufitar dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror.

Konkretisht, projektligji synon përafrimin me rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”, numri CELEX32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.77, datë 23.3.2016.

Si dhe direktivat e reja të rregullores (BE) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit:

- Regulation (EU) 2019/1896 of the European Parliament and of the Council of 13 November 2019 on the European Border and Coast Guard and repealing Regulations (EU) No 1052/2013 and (EU) 2016/1624.

- Commission Implementing Regulation (EU) 2021/581 of 9 April 2021 on the situational pictures of the European Border Surveillance System (EUROSUR).

- Regulation (EC) No 1931/2006 of the European Parliament and of the Council of 20 December 2006 laying down rules on local border traffic at the external land borders of the Member States and amending the provisions of the Schengen Convention.

Përgjithësisht, synimi i nismës ligjore është përmbushja e objektivave afatgjatë të përcaktuar në programin e qeverisë, konkretisht objektivi “Politika e Jashtme dhe e Sigurisë, si dhe integrimi evropian”.

Në veçanti, objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë kryesisht, por pa u kufizuar, përforcimi i kontrollit dhe mbikëqyrja e kufijve, parandalimi dhe goditja e krimit ndërkufitar, parandalimi i migracionit të paligjshëm, rritja e parametrave të sigurisë kufitare dhe kombëtare:

- Rritja e nivelit të përputhshmërisë me standardet evropiane dhe të Schengen, në aspektin legjislativ, administrativ e institucional në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, veçanërisht në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, forcimi i bashkëpunimit mes agjencive dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

- Krijimi i Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, në përputhje me Rregulloren e EUROSUR.
- Rregullore e miratuara me VKM mbi përcaktimin e rregullave të trafikut lokal të kufirit, procedurave të lëshimit, formës, elementëve të sigurisë dhe specifikimeve teknike të lejes së trafikut lokal të kufirit.
- Rritja e sigurisë në zonën e verifikimit kufitar;
- Përmirësimi i Sistemit për mbikëqyrjen e hapësirës detare, kontrollit kufitar dhe kërkim shpëtimit në det.
- Përcaktimi i rregullave të qarkullimit lokal kufitar, duke sanksionuar zbatimin e qarkullimit lokal kufitar, regjimin e qarkullimit lokal kufitar, pajisjen me lejen e qarkullimit lokal kufitar, kushtet, përmbajtja, forma dhe elementet e sigurisë së lejes së qarkullimit lokal kufitar si dhe lehtësimi i qarkullimit lokal kufitar;

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji hartohet në përputhje me Programin Politik të Qeverisë, në veçanti prioriteti i përforcimit të rendit dhe sigurisë publike, si dhe është i planifikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për Ministrinë e Brendshme, për vitin 2024, katërmujori i dytë, dhe në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian.

Gjithashtu, me Strategjinë Ndërsektoriale e MIK 2021-2027, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1117, datë 16.12.2020.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Projektligji “Për kontrollin e kufirit shtetëror” është hartuar si një domosdoshmëri për plotësimin e paketës së akteve ligjore që synojnë përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit kufitar.

Projektligji “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, të ndryshuar, është parashikuar në katërmujorin e dytë të vitit 2024, i cili në mënyrë të përmblodhur përmban ndryshimet e mëposhtme:

- Aktualisht, kemi në fuqi disa ligje që kanë lidhje me kufirin shtetëror, kontrollin kufitar dhe mbikëqyrjen e kufirit, të cilat janë:
1. Ligji nr. 8771, datë 19.04.2001 “Për kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë”.
 2. Ligji nr. 9861, datë 24.01.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror” i ndryshuar.

3. Ligji nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar” i ndryshuar.

- Ndarja e neneve të shtuara për API/PNR nga ligji 71/2016 “Për kontrollin kufitar” i ndryshuar;
- Përfshirja e dispozitave të pashfuqizuara të ligjit nr. 9861, datë 24.1.2008, “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”, të ndryshuar;
- Përafrimi me Rregulloren e ngritjes së sistemit të mbikëqyrjes së kufirit (EUROSUR);
- Përafrimi dhe përfshirja në ligjin e ri të Rregullores të trafikut kufitar lokal;
- Harmonizimi i plotë me direktivat e BE-së dhe përmbushja e rekomandimeve të KE-së në aspektin legjislativ, administrativ e institucional në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, veçanërisht në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit.
- Përafrimi i mëtejshëm i ligjit të ri për kontrollin kufitar me Kodin Shengen;
- Krijimi i Qendrës Kombëtare të Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit. Qendra Kombëtare e Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, si një strukturë që synon shkëmbimin në kohë reale të informacionit dhe bashkëpunimin e menjëhershëm midis të gjitha autoriteteve kombëtare me përgjegjësi për mbikëqyrjen e kufirit, me të tjera qendra kombëtare të koordinimit të vendeve të tjera, si dhe me Agjencinë Evropiane të Rojes Kufitare dhe Bregdetare, FRONTEX;
- Përcaktimi i rregullave të qarkullimit lokal kufitar, duke sanksionuar zbatimin e qarkullimit lokal kufitar, regjimin e qarkullimit lokal kufitar, pajisjen me lejen e qarkullimit lokal kufitar, kushtet, përmbajtja, forma dhe elementet e sigurisë së lejes së qarkullimit lokal kufitar si dhe lehtësimi i qarkullimit lokal kufitar;
- Rritjen e sigurisë në zonën e verifikimit kufitar, duke kufizuar ndërtimin apo zhvillimin e aktiviteteve private brenda zonës së sigurisë kufitare. Gjithashtu, përcaktohet kufiri i zonës së verifikimit kufitar, 2 km në brendësi të territorit. Brenda kësaj zone, rojat kufitare janë të autorizuar të kryejnë verifikime kufitare, sipas kompetencave të dhëna atyre në këtë ligj.

Efektet e pritshme të miratimit të këtij projektligji vlerësohen të jenë pozitive për komunitetin. Në veçanti, rritja e sigurisë kombëtare dhe rendit publik, lufta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar e krimeve të rënda, do të shoqërohen me rritjen e besimit të opinionit publik për agjencitë ligjzbatuese.

Efektet e pritshme:

- Rritja e nivelit të përputhshmërisë me standardet evropiane dhe të Shengen, në aspektin legjislativ, administrativ e institucional në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, veçanërisht në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, forcimi i bashkëpunimit mes agjencive dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.
- Përmirësimi i Sistemit për mbikëqyrjen e hapësirës detare, kontrollit kufitar dhe kërkim shpëtimit në det.

- Reduktimi i vulnerabilitetit (ndjeshmërisë) në kufi duke reaguar në mënyrë më efektive me vendosjen e burimeve të disponueshme, bazuar në analizën e rrezikut të kryer dhe kërcënimit që mund të ndikojë në sigurinë kufitare.
- Bashkëpunim i zgjeruar ndërinstitutional në menaxhimin e integruar të kufijve për të përmirësuar qarkullimin ndërkufitar, përmirësimin e sigurisë kufitare, luftën ndaj krimit ndërkufitar, mbrojtjen e jetës, shëndetit e pronës e njerëzve, shëndetin e kafshëve, bimësinë dhe ekosistemet përgjatë kufirit shtetëror.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht me vendet fqinje, institucionet e BE-së dhe Agjencinë Evropiane të Rojes Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX), për çështjet e kufijve, parandalimin e migracionit të paligjshëm, krimin ndërkufitar dhe ripranimin e personave me qëndrim të parregullt.
- Përmirësimi i infrastrukturës në Pikat e Kalimit Kufitar me qëllim krijimin e kushteve që sigurojnë kalim të lehtësuar e të sigurt të shtetasve e mallrave.
- Rritja e forcës zbuluese kundër krimit ndërkufitar nëpërmjet rritjes së profesionalizimit dhe kapaciteteve teknike e strukturore për goditjen e fenomenit të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara për kalimin e kufirit.
- Rritja e kapaciteteve të PKM për hetimin dhe goditjen e rasteve dhe rrjeteve të kontrabandimit dhe trafikimit, duke u fokusuar të kontrabandimi i personave, e veçanërisht migrantëve e minorenëve.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit”, i ndryshuar, ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, si dhe është në harmoni me rendin juridik të brendshëm.

Gjithashtu, projektligji është në harmoni me legjislacionin ndërkombëtar përkatës, konkretisht me rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”, numri CELEX32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.77, datë 23.3.2016.

- Regulation (EU) 2019/1896 of the European Parliament and of the Council of 13 November 2019 on the European Border and Coast Guard and repealing Regulations (EU) No 1052/2013 and (EU) 2016/1624.

- Commission Implementing Regulation (EU) 2021/581 of 9 April 2021 on the situational pictures of the European Border Surveillance System (EUROSUR).

- Regulation (EC) No 1931/2006 of the European Parliament and of the Council of 20 December 2006 laying down rules on local border traffic at the external land borders of the Member States and amending the provisions of the Schengen Convention.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji është është përafuar pjesërisht me:

- Rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”, numri CELEX32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.77, datë 23.3.2016.

- Regulation (EU) 2019/1896 of the European Parliament and of the Council of 13 November 2019 on the European Border and Coast Guard and repealing Regulations (EU) No 1052/2013 and (EU) 2016/1624.

- Commission Implementing Regulation (EU) 2021/581 of 9 April 2021 on the situational pictures of the European Border Surveillance System (EUROSUR).

- Regulation (EC) No 1931/2006 of the European Parliament and of the Council of 20 December 2006 laying down rules on local border traffic at the external land borders of the Member States and amending the provisions of the Schengen Convention.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, parashikon si më poshtë:

Kreu I “Dispozita të përgjithshme” përbëhet nga nenet 1-4.

Kreu II “Kufiri shtetëror” përbëhet nga nenet 5-8.

Kreu III “Kontrolli kufitar” përbëhet nga nenet 9-22.

Kreu IV “Rregullat e qarkullimit kufitar” përbëhet nga nenet 23-29.

Kreu V “Mbikqyrja e kufirit” përbëhet nga nenet 30-38.

Kreu VI “Administrimi i të dhënave personale”, përbëhet nga nenet 39-40.

Kreu VII “Sanksionet” përbëhet nga nenet 41-42.

Kreu VIII “Dispozita përfundimtare” përbëhet nga nenet 43-46.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet për zbatimin e këtij projektakti, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe Autoritetet Kompetente të përcaktuara në projektligj.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projektligji ka kontribuar Policia e Shtetit/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, si dhe Ministria e Brendshme/Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Drejtoria e Politikave Strategjike për Rendin & Sigurinë Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave/Ministria e Financave, AKU/ Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, Ministria e Mbrojtjes/QNOD.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efekti financiar për hartimin dhe miratimin e ligjit do të jetë vetëm kosto administrative, pagat e punonjësve që do të marrin pjesë sipas urdhrave për ngitjen e grupeve të punës. Kjo shumë duke qenë se nuk është e konsiderueshme, do të përballohet nga programi buxhetor “Për policinë e shtetit” të miratuar për periudhat përkatëse.